

Thirrja është e hapur nga data 19.06.2024 deri me 27.06.2024

TERMAT E REFERENCES

RESTAURANTE TË CILËT OFROJNË SHËRBIME BAZUAR NË KRITER E KËRKUARA PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATËS NEVO KONCEPTI.

Organizata	OJQ "NEVO KONCEPTI"
Objektiva	Përshkrimi i oferës së ushqimit në restaurant dhe ushqimit të shpejtë nga mënyja e ofruesit dhe salla për takime.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 4 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

Sqarim:

Në lidhje me aplikim për ofrimin e ofertave për shërbimet e cekura më poshtë mund të aplikojn restaurantet të cilat përmbushin kriteret e kërkuara nga komuna e Fushë Kosovës.

2. Detyrat dhe Përgjegjësit

- Mirëpritja e stafit dhe antarëve të cilët do të marrin pjesë në aktivitetin të cilin do të zhvillohet në Restuarant.
- Përgaditja e ushqimit sipas kërkesës, nga ana përfaqësuesve të OJQ "Nevo Konceptit".
- Salla e takimeve të plotsojë kushtet për zhvillimin e takimeve, trajnimeve dhe konferencave.
- Përgatitja e faturës me kohe dhe pritshmëria e pagesës përmes transferit bankarë.
- Zbritja e TVSH-s në faturim bazuar në dokumentin e ofruar nga OJQ "Nevo Koncepti" e cila lirohet nga TVSH-ja në bazë të UA Nr.03/2015 për TVSH.

3. Afati Kohorë

Njoftimi i përfaqësuesve të restorantit për zhvillimin e aktiviteteve të caktuara do të jetë dy ditë më parë para zhvillimit të aktivitetit për shkak të përgaditjes.

4. REZULTATET E PRITSHME

- Bashkëpunim të mirëfillt.
- Ushqimi dhe pijet të jenë me qmime të njëjta gjatë periudhës së kontratës.
- Ushqimi dhe pijet të jenë kualitative.
- Përgatitja e ushqimit me kohë dhe i freskët,
- Salla e Konferencave të ketë kushtet të cilat i përmbushë për mbajtjen e aktivitetit.

5. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

Kërkesa për ofertë (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur)

Oferta

Kopja e dokumentit të ARBK-s së bizenit.

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 27.06.2024** deri në fund të orarit 16:00 në email m.elshani@nevokoncepti.org duke e kopjuar në (cc) dhe emailin o.osmani@nevokoncepti.org.